



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Deklarata e Performancës së AMMK 2025

Data:	23.03.2026
AGJENCIA	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
MINISTRIA PËRGJEGJËSE	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR VLERËSIMIN E PËRFORMACËS	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
Miratimi i Raportit të Performancës	Po

Vlerësimi Përshkrues i Performancës

Vlerësimi përshkrues i Performancës së AMMK për vitin 2025, është bërë bazuar në dispozitat e Rregullores (QKR) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore.

Njësia Përgjegjëse (Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit i MMPH) me datë 09.02.2026, ka pranuar Raportin Vjetor të Performancës së AMMK për vitin 2025 të përgatitur nga Agjencia.

Gjatë procesit të vlerësimit Njësia Përgjegjëse është konsultuar me AMMK dhe bazuar në rezultatet e Raportit Vjetor të Performancës së AMMK për vitin 2025, ka hartuar vlerësimin përshkrues të performancës si në vijim:

- Plani i Performancës së AMMK për vitin 2025 i përgatitur sipas Shtojcës I të Rregullores (QKR) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për

agjencitë në kuadër të administratës shtetërore ka pasur 5 objektiva kryesore të përcaktuara sipas kriterëve përkatëse.

- Secila nga objektivat ka pasur treguesit, vlerën bazë, vlerën e synuar, rezultatet e pritshme, alokimin financiar dhe referenca ndaj dokumenteve strategjike/politike.
- Raporti Vjetor i Performancës së AMMK-së për vitin 2025, i përgatitur sipas Shtojcës II të Rregullores (QKR) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore ka ofruar të dhëna për nivelin e zbatimit të objektivave, treguesit e arritshmërisë, vlerat e synuara, vlera faktike, rezultatet e planifikuara, rezultatet e përfunduara dhe ato të papërfunduara, dhe shënimet shpjeguese.
- Gjithashtu Raporti ka ofruar të dhëna plotësuese dhe dëshmi mbi rezultatet e arritura.
- Nga Raporti Vjetor i Performancës së AMMK-së për vitin 2025, wshtw konstatuar se nga 5 objektivat e përcaktuara 4 prej tyre janë realizuar plotësisht dhe vetëm 1 nga to është realizuar pjesërisht.
- Bazua në informatat e paraqitura në Raportin Vjetor të Performancës për objektivat e Planin Vjetor të Performancës së AMMK-së për vitin 2025, është konstatuar se nuk ka opinion "të kundërt" ose "mohim opinionin", nga Raporti i fundit i Auditorit të Përgjithshëm për AMMK.
- Bazuar në rezultatet në Raporti Vjetor i Performancës së AMMK-së për vitin 2025, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka treguar performancë pozitive në të gjitha fushat e përgjegjësisë së saj të përcaktuara në objektivat përkatëse.
- Rezultatet për arritjen e objektivave ofrojnë dëshmi për realizimin e vlerave të synuara për treguesit përkatës.
- Raporti ka ofruar dëshmi dhe burime konkrete për verifikimin e rezultateve të arritura.

Bazuar në të gjeturat përkatëse të prezantuara më lartë Njësia Përgjegjëse konstaton se Deklarata e Performancës për AMMK për vitin 2025, është pozitive meqenëse nga informatat e paraqitura në Raportin e Performancës dhe diskutimet bilaterale është konstatuar se Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka arritur objektivat e parapara me Planin e Performancës për vitin 2025..


Prioritetet e performancës

Bazuar në dispozitat e Rregullores (QKR) nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore, në kuadër të vlerësimit përshkrues të performancës për Planin e Performancës së AMMK për vitin 2025, kërkohet po ashtu që të jepen edhe propozime për prioritetet e performancës për të ardhmen.

Lidhur me prioritetet e performancës dhe me qëllim të përmirësimit të performancës së AMMK për të ardhmen Njësia Përgjegjëse për Vlerësimin e Raportit Vjetor të Performancës së AMMK-së jep rekomandimet si në vijim:

- Objektivat e Planit të Performancës së AMMK duhet të jenë në harmoni me Planin e Punës së AMMK, planin e punës së MMPHI dhe me prioritetet strategjike dhe të politikave të Qeverisë.
- Treguesit e arritshmërisë duhet të jenë më realist, më specifik dhe me të matshëm sikurse edhe vlerat faktike dhe ato të synuara.
- Në fushat ku objektivi nuk është arritur plotësisht të analizohet treguesit dhe vlerat e arritura me qëllim të përmirësimit të zbatimit për të ardhmen. Mos arritja e plotë e objektivit "Përmirësimi i shërbimeve dhe promovimi i MNRV "Shpella e Gadimes", është arsyetuar me faktorë të jashtëm, si kushtet ekonomike dhe ndryshimet në flukset turistike. Edhe pse ky shpjegim konsiderohet i arsyeshëm megjithatë, në të ardhmen do të ishte e dobishme të paraqitet një analizë më e detajuar e trendeve të vizitorëve dhe e ndikimit konkret të aktiviteteve promovuese.
- Për të gjitha objektivat e propozuara rekomandohet që të bëhet edhe alokimi i nevojshëm dhe i qëndrueshëm financiar dhe në mënyrë specifike për rrjetet e monitorimit si dhe avancimin e digjitalizimit dhe sistemeve të raportimit.
- Rekomandohet po ashtu që të përfshihen tregues shtesë nga fushat e përgjegjësisë të AMMK, me qëllim të gjithëpërfshirës së Planit të Performancës së AMMK për të ardhmen.

Fitore Pacolli-Dalipi, Ministre e MMPH

 30.03.2026

(nënshkrimi dhe data)